



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 977 Prot.

Tiranë, më datë 29.10.2020

**VENDIM**

**Nr. 359, datë 29.10.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.10.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Shërbime projektimi për projektin teknik dhe marrja e lejes së ndërtimit për rindërtimin e objektit njësi banimi (pallat), zona pikësore, Durrës, pallati Nr. 14 – Bulevardi Dyrrah”, brënda kufirit të zonës arkeologjike “A”, me aplikues “ARKONSTUDIO” sh.p.k. dhe zhvillues Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
  2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me Institutin e Arkeologjisë, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore/monitorojë kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Shërbime projektimi për projektin teknik dhe marrja e lejes së ndërtimit për rindërtimin e objektit njësi banimi (pallat), zona pikësore, Durrës, pallati Nr. 14 – Bulevardi Dyrrah” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë;
  3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
  5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**

**Arta DOLLANI**